



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**KUVENDI
KOMISIONI I POSAÇËM PARLAMENTAR
“PËR THELLIMIN E REFORMAVE PËR MIRËQEVERISJEN,
ANTI-KORRUPSIONIN DHE SUNDIMIN E LIGJIT PËR SHQIPËRINË 2030 NË
BASHKIMIN EUROPIAN”**

**RELACION PËR PROJEKTVENDIMIN
“PËR MIRATIMIN E PLANIT KOMBËTAR TË VEPRIMIT NË ZBATIM TË
DOKUMENTIT ANALITIK TË KOMISIONIT TË POSAÇËM PARLAMENTAR
“PËR THELLIMIN E REFORMAVE PËR MIRËQEVERISJEN,
ANTI-KORRUPSIONIN DHE SUNDIMIN E LIGJIT PËR SHQIPËRINË 2030 NË
BASHKIMIN EUROPIAN”**

DOKUMENT PARLAMENTAR
masl.al

RELACION PËR PROJEKTVENDIMIN
“PËR MIRATIMIN E PLANIT KOMBËTAR TË VEPRIMIT NË ZBATIM TË
DOKUMENTIT ANALITIK TË KOMISIONIT TË POSAÇËM PARLAMENTAR
“PËR THELLIMIN E REFORMAVE PËR MIRËQEVERISJEN, SUNDIMIN E
LIGJIT DHE ANTIKORRUPSIONIN PËR SHQIPËRINË 2030 NË BASHKIMIN
EUROPIAN”

I. Qëllimi i projektaktit dhe objektivat që synohet të arrihen

Kuvendi i Shqipërisë, mbështetur në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë dhe në Rregulloren e Kuvendit, në reflektim dhe në zbatim të rekomandimeve të progresraportit dhe raportit *screening* të Komisionit Europian 2023, si dhe në kuadër të vendimmarrjes së negociatave me BE-në, më datë 27 maj 2024, miratoi rezolutën “Për thellimin e reformave për mirëqeverisjen, sundimin e ligjit dhe antikorrupsionin për Shqipërinë 2030 në Bashkimin Europian”.

Në zbatim të kësaj rezolute, Kuvendi me vendimin nr. 50, datë 30.5.2024, vendosi ngritjen e Komisionit të Posaçëm Parlamentar “Për thellimin e reformave për mirëqeverisjen, sundimin e ligjit dhe antikorrupsionin për Shqipërinë 2030 në Bashkimin Europian” dhe me vendimin nr. 53, datë 6.6.2024, vendosi përbërjen e anëtarëve të Komisionit të Posaçëm Parlamentar.

Në kontekstin e procesit të anëtarësimit të Shqipërisë dhe nevojës së një angazhimi më të madh nga të gjithë aktorët për përmbushjen e kriterëve të negociatave, veçanërisht të Grup-kapitullit I “Themeloret”, Kuvendi vlerësoi se thellimi i ciklit të reformave në fushat e mirëqeverisjes; antikorrupsionit dhe sundimit të ligjit përbën një domosdoshmëri për zhvillimin e vendit me ritme më të shpejta për konsolidimin e demokracisë dhe shtetit të së drejtës. Thellimi i reformave në këto fusha gjithashtu jep garanci më të forta për procesin e negociatave, për një ritëm të lartë angazhimi në këtë proces të tri pushteteve dhe agjencive të ndryshme në varësi të tyre, si dhe për avancimin e mëtejshëm për përmbushjen e piketave kryesore të negociatave për anëtarësimin e vendit në BE.

Për t’i dhënë një frymë e qasje të re thellimit të reformave shtetformuese, në ushtrimin e prerogativave të tij kushtetuese, Kuvendi me këtë komision të posaçëm synoi të ndërhyjë duke marrë një rol udhëheqës në drejtim të mirëqeverisjes, thellimit të luftës ndaj korrupsionit dhe sundimit të ligjit për të hartuar një plan masash dhe për të adresuar në këtë mënyrë sfidat e përsëritura, me të cilat përballet vendi. Kjo do të shërbejë për qytetarët për qeverisje më të mirë dhe më llogaridhënëse, për parandalimin dhe luftën ndaj korrupsionit dhe sundimit të ligjit, ashtu si dhe të ndihmojë me rolin e tij për përshpejtimin e procesit të anëtarësimit të Shqipërisë në BE. Qëllimi kryesor i veprimtarisë së këtij komisioni është adresimi i ndërmarrjes së reformave që synojnë mirëqeverisjen, sundimin e ligjit dhe antikorrupsionin për “Shqipërinë 2030 në Bashkimin Europian”, të cilat u realizuan nëpërmjet një vlerësimi/analize të thelluar të situatës në këto tri fusha dhe me hartimin e një Plani Kombëtar Veprimi me kohështrirje afatgjatë, duke rekomanduar, për sa çmohet e nevojshme, edhe masa konkrete për ndryshime të mundshme ligjore dhe institucionale, të cilat duhet të zbatohen në secilën fushë nga institucionet përgjegjëse.

Në këtë frymë, komisioni i posaçëm parlamentar u angazhua me misionin institucional dhe kushtetues për thellimin e reformave në funksion të objektivit strategjik "Shqipëria 2030 në BE", me qëllim që përmes një procesi multidimensional publik, gjithëpërfshirës, transparent, profesional dhe në reflektim të standardeve më të mira ndërkombëtare, si 4 parimet kryesore bazë, mbështetur në mekanizmat, rregullat dhe procedurat përkatëse parlamentare dhe me angazhimin e kontributit aktiv të ekspertizës më të mirë vendase dhe ndërkombëtare, të realizojë drejtimin dhe koordinimin e një procesi të thelluar të reformave në mirëqeverisje, luftën kundër korrupsionit dhe sundimin e ligjit.

Me qëllim garantimin e përfshirjes së të gjithë aktorëve të tjerë jopolitikë, por edhe për të garantuar pavarësinë dhe profesionalizmin e dokumenteve që u hartuan, pranë KPP-së u ngrit dhe funksionoi Grupi i Ekspertëve të Nivelit të Lartë (GENL), i asistuar nga Sekretariati Teknik, që është i përbërë nga staf i Kuvendit dhe përfaqësues/ekspertë të institucioneve publike. Ky grup u ngrit pas një procesi tërësisht transparent dhe publik, me qëllim përfitimin e ekspertëve profesionalisht më të mirë, por edhe si përfaqësues të aktorëve të ndryshëm të rëndësishëm në këtë proces. GENL-ja përbëhet në total nga 119 ekspertë të nivelit të lartë, nga të cilët 69 ekspertë të nivelit të lartë vendas dhe 50 ekspertë ndërkombëtarë. Nga ekspertiza vendase, 12 ekspertë ishin propozime nga institucionet dhe agjencitë e pavarura, 22 ekspertë nga bota akademike, 23 ekspertë të propozuar nga 21 organizata të shoqërisë civile dhe 12 ekspertë nga komuniteti i biznesit. Pjesë e GENL-së kanë qenë edhe 19 konsulentë të jashtëm nga diaspora, 14 konsulentë të huaj, si dhe 17 ekspertë të organizatave ndërkombëtare.

Ekspertët shqiptarë nga diaspora kishin eksperiencë në fusha të ndryshme, që e ushtrojnë veprimtarinë e tyre në universitetet më të mira europiane, profesionistë të fushës së ligjit, ekspertë për çështjet europiane në organizata të ndryshme, si në Itali, Holandë, Gjermani, Francë, Austri, Angli, SHBA, Kanada, etj, magjistratë të vendeve europiane, që shërbejnë në vende të ndryshme si profesorë në universitete etj. Nga ekspertiza e huaj 14 konsulentë të jashtëm janë kryesisht pedagogë të huaj, të cilët e ushtrojnë veprimtarinë e tyre në disa universitete të njohura europiane, magjistratë të vendeve europiane, ekspertë që kanë punuar me agjenci të ndryshme ndërkombëtare, që e njohin realitetin shqiptar, pasi kanë dhënë edhe më parë ekspertizën e tyre në këto fusha. Me kërkesë të KPP-së, për ta asistuar e për të monitoruar zbatimin e standardeve më të mira europiane në këtë proces, janë ftuar të kontribuojnë ekspertë nga organizata dhe institucione ndërkombëtare që aktualisht operojnë në Shqipëri, ose me seli në vende të tjera, përmes projekteve të tyre të akredituara në Tiranë. 17 ekspertë nga organizatat ndërkombëtare kanë dhënë kontribute me shkrim, me opinione të vlefshme rreth draftit të Dokumentit Analitik dhe draftit të PKV-së, të cilat janë reflektuar prej GENL-së në dokumentet përkatëse. Ekspertiza ndërkombëtare u ofrua nga delegacioni i BE-së, Këshilli i Europës, GRECO-ja, OGP-ja, OSBE-ja, Banka Botërore, NDI-ja, USAID-i, ambasadat e SHBA-së, franceze, zvicerane etj., përmes projekteve të tyre të akredituara në Tiranë. Një pjesë e tyre kanë qenë pjesë e debateve *online* ose kanë qenë pjesëmarrës aktivë në tryezat e konsultimit publik.

Të gjithë ekspertët e GENL-së janë propozime të aktorëve të sipërpërmendur, ku KPP-ja ka rol vetëm për miratimin e tyre në mbledhje publike dhe ndarjen në grupe pune sipas ekspertizës. Asnjë ekspert nuk është përzgjedhje apo vendimarrje e mazhorancës, por vullnet i lirë përfaqësimi nga aktorët jopolitikë të përfshirë në këtë proces. Në radhët e ekspertëve ka persona që në vijimësi kanë mbajtur qëndrime të forta publike, oponentë ndaj mazhorancës aktuale, duke u dhënë mundësi të shprehin lirisht mendimin e tyre në proces dhe në përmbajtjen e dokumenteve të hartuara nga GENL-ja.

Në metodologjinë e punës së miratuar KPP-ja drejtoi, mbështeti dhe koordinoi procesin e reformës, ndërsa i gjithë procesi i hartimit të dokumenteve dhe akteve, që rrjedhin prej tyre, u krye nga GENL-ja, mbështetur nga Sekretariati Teknik (ST). Të gjitha tryezat janë moderuar dhe kanë prezantuar përfaqësuesit e grupeve të ekspertëve për çështjet respektive.

Për të garantuar transparencën, KPP-ja që në krijimin e saj dhe gjatë gjithë procesit dhe fazave të ndjekura ka ndërmarrë masat për të informuar në kohë reale dhe në mënyrë transparente publikun dhe aktorët e interesuar për t'i bërë pjesë të procesit, si më poshtë:

- Krijimi i një uebsajti të dedikuar www.masl.al. Komisioni ka ngritur një faqe të dedikuar uebsajti, që është dizenuar si një platformë informacioni dhe ndërveprimi me grupet e interesit, profesionistët e fushës dhe vetë qytetarët. Kjo faqe zyrtare e KPP-së është populluar me informacionin e duhur për të qenë transparente me publikun lidhur me veprimtarinë dhe dokumentacionin përkatës.
- Publikimi i 12 buletineve periodike informative mujore (shqip-anglisht) në uebsajtin e dedikuar (www.masl.al) dhe shpërndarja me *email* tek të gjithë aktorët, lidhur me veprimtarinë mujore dhe ecurinë e proceseve.
- Janë zhvilluar 12 mbledhje komisioni, të cilat kanë qenë publike, të transmetuara *live* në faqen ueb të Kuvendit dhe të komisionit, si dhe në rrjetet sociale të Kuvendit.
- Publikimi në uebsajt i 29 vendimeve të veprimtarisë së mbledhjeve të KPP-së.
- Janë zhvilluar disa takime periodike informuese me gazetarët dhe përfaqësuesit e medias, për t'i informuar për aktivitetin e KPP-së dhe procesin e ndjekur nga GENL-ja.
- Takime periodike me shoqërinë civile që monitorojnë procesin dhe aktorë të tjerë ndërkombëtarë për t'i informuar për të gjitha fazat e procesit.
- Transmetimi *live* i të gjitha takimeve të komisionit dhe tryezave tematike të zhvilluara për t'u ndjekur *live* nga media dhe çdo i interesuar, të cilat gjenden në uebsajtin dedikuar komisionit dhe atë të Kuvendit.

Konsultimi publik për të gjitha fazat e veprimtarisë së komisionit dhe të gjitha dokumentet është zhvilluar me të gjitha mjetet dhe mekanizmat për të përfshirë aktorët politikë dhe jopolitikë, aktorët e shoqërisë civile dhe qytetarët nëpërmjet takimeve, tryezave të konsultimit, forumeve në Tiranë dhe në rrethe të tjera etj.

Për të konsultuar gjerësisht dokumentet e KPP-së, si Dokumentin Analitik dhe Planin Kombëtar të Veprimit për të tria shtyllat, “Mirëqeverisja”, “Antikorrupsioni dhe “Sundimi i ligjit”, janë realizuar:

- Publikimi në uebsajtin e dedikuar të KPP-së të dy draftdokumenteve për tre muaj, me qëllim konsultimin publik para miratimit të tyre nga komisioni.
- Janë zhvilluar 11 tryeza të rumbullakëta publike me të gjithë aktorët për të konsultuar dhe për të diskutuar çështjet e Dokumentit Analitik dhe Planit Kombëtar të Veprimit.
- 1 100 pjesëmarrës kanë marrë pjesë aktivisht në tryezat e rumbullakëta, duke kontribuar me komente dhe sugjerime për përmirësimin e dokumenteve të komisionit.
- Janë zhvilluar 8 forume, “Dialog qytetar”, jashtë Tiranës, në qytete të ndryshme, kryesisht në qendra universitare, si Shkodër, Korçë, Vlorë, Durrës, Elbasan, Berat, në të cilët kanë marrë pjesë pedagogë dhe studentë, përfaqësues të pushtetit vendor,

përfaqësuesve të shoqërisë civile dhe komunitetit lokal të biznesit dhe qytetarë të interesuar.

- Janë organizuar 2 konferenca të nivelit të lartë për prezantimin e dokumenteve sipas fazave të realizuara, konkretisht në dhjetor 2024 për Dokumentin Analitik dhe në prill 2025 për Planin Kombëtar të Veprimit.
- Janë zhvilluar 3 tryeza debati në prill 2025 me rreth 350 pjesëmarrës për të prezantuar dokumentet finale të të tria shtyllave edhe për t'i konsultuar me pjesëmarrje shumë të gjerë. Në këto tryeza prezantimi i dokumenteve u krye nga ekspertë vendas të GENL-së, por edhe ata të huaj, të cilët dhanë perspektivën e tyre lidhur me përafrimin e standardeve të vendeve të BE-së. Tryezat e debatit janë publikuar *online* dhe gjenden në faqen e dedikuar dhe në rrjetet sociale të Kuvendit.
- 351 komente dhe sugjerime janë përfituar nga konsultimet publike të të gjithë aktorëve, të cilat GENL-ja i ka trajtuar me profesionalizëm dhe transparencë duke i pasqyruar ato që janë pranuar në një dokument të posaçëm, si dhe komentet dhe argumentet për secilën prej tyre.
- 50 ekspertë kombëtarë dhe të huaj kanë prezantuar dokumentet dhe drejtuar tryezat dhe konferencat e realizuara sipas fazave dhe proceseve.
- Prezantimi i dokumenteve themelore të hartuara nga KPP-ja me partnerët ndërkombëtarë, me DG ENEST dhe DG JUST nga Komisioni Europian, DG1 të Këshillit të Europës dhe zyrën e OGP-së për rajonin gjatë muajit shkurt 2025 nga grup anëtarësh të KPP-së dhe përfaqësues të GENL-së.

Synimi kryesor i KPP-së që në fillim dhe i gjithë ky proces në vetvete, veçanërisht dokumentet që janë hartuar së bashku me propozimet përkatëse, është që të reflektojnë përvojat dhe standardet më të mira ndërkombëtare në këto fusha dhe të jenë në përputhje të plotë me rekomandimet e BE-së dhe kriteret për pozicionet negociuese.

Për këtë arsye si udhërrëfyes dhe kornizë e këtij procesi nga GENL-ja për të tria shtyllat janë konsultuar dokumente të rëndësishme për përmbushjen e kriterëve të procesit të negociatave, siç janë: rekomandimet e raportit *screening* për Grup-kapitullin I “Themeloret”; udhërrëfyesit e miratuar, si për shtetin e së drejtës, reformën në administratën publike dhe funksionimin e institucioneve të pavarura; Agjendën Kombëtare të Reformave 2024-2030; piketat hapëse dhe të ndërmjetme të dokumentit të përbashkët të Komisionit Europian për pozicionin negociues të Grup-kapitullit I “Themeloret”; raportin e KE-së (2024) “Për shtetin e së drejtës”; rekomandimet e raporteve të mekanizmave të Këshillit të Europës, si MONEYVAL-i dhe GRECO-ja; raundin e pestë të monitorimit të DASH-it; *Transparency International*; raportin e OECD/SIGMA (2025); raportin e vlerësimit të OGP-së (IRM 2023-2025) etj.

Komisioni i posaçëm parlamentar asistoi dhe mbështeti këtë proces duke miratuar dokumentet e hartuara dhe të konsultuara nga GENL-ja. KPP-ja, bazuar edhe në parashikimet e rezolutës dhe vendimit nr. 50 të Kuvendit, e zhvilloi punën e tij në 3 faza kryesore, në të cilat u hartuan dhe miratuan edhe dokumentet përkatëse:

1. Hartimi dhe miratimi i Dokumentit Analitik, duke realizuar një analizë të situatës aktuale në të tria shtyllat.
2. Hartimi dhe miratimi i Planit Kombëtar të Veprimit, me kohështrirje afatgjatë e të qëndrueshme, me masa e indikatorë konkretë për adresimin e sfidave përkatëse në këto fusha, duke përcaktuar edhe mekanizmat për zbatimin, monitorimin e mbikëqyrjen e tyre.

3. Draftimi dhe propozimi i projektligjeve dhe masave/projekteve për ndryshime të mundshme institucionale që do të dakordësohen mbi bazën e PKV-së.

Në bazë të punës dhe ekspertizës së ofruar, u hartua Dokumenti Analitik si përmbyllje e fazës së parë. Pas një procesi gjithëpërfshirës konsultimi me institucionet shqiptare, organizatat ndërkombëtare dhe me grupet interesi, komisioni i posaçëm parlamentar miratoi në seancë publike Dokumentin Analitik, konkretisht nëpërmjet akteve në vijim: i) Vendim nr. 22, datë 19.2.2025, “Për miratimin e Dokumentit Analitik për shtyllën e parë “Mirëqeverisja”; ii) vendim nr. 24, datë 19.02.2025 “Për miratimin e Dokumentit Analitik për shtyllën e dytë “Antikorrupsioni”; iii) vendim nr. 25, datë 26.02.2025, “Për miratimin e Dokumentit Analitik për shtyllën e tretë “Sundimi i ligjit”.

Plani Kombëtar i Veprimit (në vijim PKV) është dokumenti më i rëndësishëm dhe dokumenti i parë i hartuar nga Kuvendi lidhur me thellimin e reformave për mirëqeverisjen, antikorrupsionin dhe sundimin e ligjit, bazuar në të gjitha gjetjet dhe rekomandimet e analizuar në Dokumentin Analitik. Plani kombëtar u hartua nga Grupi i Ekspertëve të Nivelit të Lartë (GENL), me mbështetjen e Sekretariatit Teknik (ST) të Kuvendit dhe në konsultim të gjerë me publikun, institucionet dhe organizatat ndërkombëtare. PKV-ja është një dokument konkret dhe i matshëm, me masa legislative dhe institucionale, me afate të mirëpërcaktuara dhe të linjizuara me kërkesat e BE-së, në kuadër të procesit të negociatave dhe angazhimeve të shprehura në dokumentet përkatëse të qeverisë shqiptare. PKV-ja përmban indikatorët për ta bërë të matshëm zbatimin dhe institucionet përgjegjëse për zbatim, duke vendosur theksin tek roli dhe përgjegjësitë kushtetuese dhe ligjore të Kuvendit.

Vizioni, që ka udhëhequr hartimin e PKV-së, është thellimi i reformave për konsolidimin e shtetit të së drejtës, ndërtimin e një sistemi qeverisës efikas, të hapur dhe transparent, i bazuar në integritet dhe pjesëmarrje, në parandalimin dhe luftën kundër korrupsionit, si dhe sundimin e ligjit në përputhje me standardet më të mira europiane, me prioritetin madhor anëtarësimin e Shqipërisë në BE në vitin 2030.

Qëllimi i PKV-së është të ofrojë një kuadër strategjik të qartë dhe të zbatueshëm të masave reformuese në tri shtyllat kryesore: “Mirëqeverisja, “Antikorrupsioni” dhe “Sundimi i ligjit” për të pasur rezultate të prekshme për qytetarët, si dhe nxitjen e të gjitha institucioneve për të vepruar me të njëjtën shpejtësi, përgjegjësi dhe në të njëjtin drejtim për përmbushjen e kriterëve të negociatave me BE-në. Plani Kombëtar i Veprimit përbën një dokument strategjik, i cili parashikon një sërë masash konkrete, legislative dhe institucionale, të orientuara drejt përmbushjes së përgjegjësi dhe angazhimeve të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, në kuadër të procesit të negociatave për anëtarësimin e vendit në Bashkimin Europian. Në thelb, ky plan ka si objekt kryesor thellimin e reformave përmes veprimesh të strukturuar dhe të matshme, me fokus të posaçëm forcimin e luftës kundër korrupsionit, përmirësimin e qeverisjes dhe konsolidimin e sundimit të ligjit, në përputhje me standardet dhe pritshmëritë e *acquis*-së.

Plani synon jo vetëm të adresojë sfidat strukturore dhe institucionale të konstatuara, por edhe të nxitë një transformim të thellë të kulturës politike dhe administrative, të bazuar në parimet e përgjegjshmërisë, meritokracisë, profesionalizmit dhe efikasitetit.

II. Argumentimi i projektaktit lidhur me përparësitë, problematikat, efektet e pritshme

Kuvendi i Shqipërisë, me autoritetin dhe rolin që i japin Kushtetuta dhe ligji, si dhe hapësirën gjithëpërfshirëse të krijuar prej tyre, është institucioni kushtetues kyç për drejtimin dhe koordinimin e një procesi të thelluar reformimi, me synim përmirësimin dhe konsolidimin e praktikave të mirëqeverisjes në të gjitha nivelet, thellimin e luftës kundër korrupsionit dhe forcimin e mëtejshëm të zbatimit të ligjit, duke pasur si udhërrëfyes gjetjet dhe rekomandimet e BE-së për standardet që duhet të arrijë Shqipëria për të qenë anëtare e familjes së madhe europiane në vitin 2030. Nëpërmjet rezolutës së miratuar më 27 maj 2024, Kuvendi i Shqipërisë shprehu vullnetin e qartë për të ndërmarrë një sërë angazhimesh në funksion të këtij cikli të ri reformimi për Shqipërinë 2030, për të nxitur frymën e dialogut konstruktiv dhe politik midis 3 pushteteve, për rritjen e fokusit të Kuvendit në përshpejtimin e procesit të anëtarësimit të vendit në BE, për ushtrimin e përgjegjësisë të tij kushtetuese dhe përmirësimin cilësisht të rolit ligjvënës, mbikëqyrës në funksion të mirëqeverisjes dhe respektimit të parimit të kontrollit dhe balancës (*check & balance*).

Referuar arsyeve që çuan hartimin e këtij Plani Kombëtar Veprimi theksojmë:

Shoqëria shqiptare është në një moment të rëndësishëm të ndërtimit të shtetit të së drejtës dhe forcimit të demokracisë. Në këtë kontekst, domosdoshmëria e këtij dokumenti potencohet nga nevoja për të arritur standardet e Bashkimit Europian në funksionimin e të gjitha strukturave të shtetit, jo vetëm si aspirata dhe prioriteti ynë në kuadër të anëtarësimit të Shqipërisë në BE, por edhe për të përmbushur interesat e pritshme të qytetarëve shqiptarë. Ky dokument mishëron domosdoshmërinë për të shfrytëzuar momentumin e procesit të integritimit europian, për të zbatuar masat që Shqipëria duhet të ndërmarrë në kuadër të procesit të negociatave me BE-në, veçanërisht pas hapjes së negociatave të Grup-kapitullit I “Themeloret”. Nevoja që dikton stadi i ri i vendit, pas çeljes së negociatave të anëtarësimit me Bashkimin Europian, ka nxjerrë më së miri në pah sfidat që duhet të çojnë para aktorët politikë e faktorët shoqërorë, të cilëve u takon barra e marrjes së përgjegjësisë së leximit të duhur të këtyre nevojave, e trajtimit të tyre me kompetencë të lartë profesionale dhe e adresimit të tyre përmes një plani kombëtar veprimi që orienton qasjen, ndërveprimin dhe aktivitetin e të tria pushteteve të pavarura të Republikës së Shqipërisë, për vijimin me sukses të punës së përbashkët, pavarësisht njëri-tjetrit dhe në bashkëpunim me njëri-tjetrin, për të forcuar demokracinë, për të thelluar antikorrupsionin dhe për të konsoliduar shtetin e së drejtës. KPP-ja edhe për hartimin e PKV-së në mënyrë gjithëpërfshirëse dhe transparente bashkoi të gjithë aktorët, legjislativin dhe ekzekutivin, institucionet kushtetuese dhe ato të pavarura të krijuara me ligj, shoqërinë civile, medien, botën akademike, ekspertizën më të mirë vendase, të asistuar edhe nga ekspertiza më e mirë ndërkombëtare dhe partnerët strategjikë të Shqipërisë, për të analizuar, për të diskutuar dhe për të dakordësuar hapat dhe masat që do të ndërmerren në këto 3 fusha kyçe për Shqipërinë 2030 në BE.

Komisioni i posaçëm parlamentar nëpërmjet PKV-së, si dokumenti themelor reformues, në këto 3 shtylla nëpërmjet masave të parashikuara synon:

- Adresimin e masave të nevojshme për reflektime politike, institucionale e ligjore për adresimin e 3 sfidave që impaktojnë drejtpërdrejt shoqërinë dhe procesin e anëtarësimit të Shqipërisë në BE, për përmirësimin dhe konsolidimin e praktikave të mirëqeverisjes në të gjitha nivelet, për parandalimin dhe thellimin e luftës kundër korrupsionit, si dhe forcimin e mëtejshëm të sundimit të ligjit.
- Rritjen e rolit të Kuvendit dhe të gjithë aktorëve të tjerë institucionalë për përmbushjen e përgjegjësisë të drejtpërdrejta për përshpejtimin e procesit të anëtarësimit të vendit në BE.

- Ushtrimin më eficient të përgjegjësive kushtetuese dhe përmirësimin cilësisht të rolit ligjvënës, monitorues, mbikëqyrës e koordinues të Kuvendit.
- Nxitjen e frymës së dialogut institucional midis 3 pushteteve në respektim të parimit të kontrollit dhe balancës (*check & balance*), në funksion të përgjegjësive të përbashkëta në procesin e anëtarësimit të vendit.

Plani Kombëtar i Veprimit, i hartuar dhe i miratuar nga KPP-ja, ka disa përparësi, pasi jo vetëm që konsiderohet si një dokument i Kuvendit Shqiptar i detyrueshëm për zbatim, por edhe një dokument kombëtar, i cili përfshin të gjitha degët e pushteteve dhe të shoqërisë, duke përfshirë edhe vetë qytetarët, për shkak të legjitimitetit kushtetues që ka Kuvendi. Për shkak të kompetencave dhe përgjegjësive kushtetuese e ligjore, Kuvendi nëpërmjet rolit mbikëqyrës dhe koordinues të institucioneve, duke përfshirë edhe ato kushtetuese, e bën këtë dokument gjithëpërfshirës, si një udhërrëfyes për zbatim nga të gjitha institucionet.

Duke pasur në konsideratë që roli i Kuvendit në procesin e integrimit europian është rritur në bazë të ndryshimeve ligjore, PKV-ja mund të shërbejë më mirë si një platformë gjithëpërfshirëse për të gjithë aktorët në këtë proces, për të dhënë një vlerë të shtuar për të gjitha sfidat drejt anëtarësimit në BE.

Janë hasur një sërë sfidash gjatë hartimit të PKV-së nga GENL-ja, veçanërisht për linjëzimin e të gjitha masave dhe afateve me dokumentet e BE-së, edhe për ato ku Shqipëria ka shprehur angazhimet e saj tashmë të miratuara, të cilat u kapërcyen mbi bazën e një procesi gjithëpërfshirës dhe konsultativ me Kryenegociatoren dhe grupin e negociatorëve, si dhe të gjitha ministrinë e linjës, veçanërisht ato që lidhen drejtpërdrejt me fushat që janë objekt i veprimtarisë së KPP-së.

Përmes këtij dokumenti synohen reforma të rëndësishme e komplekse në shërbim të interesit qytetar, forcimit të demokracisë dhe shtetit të së drejtës, modernizimit të mëtejshëm të shtetit, funksioneve e institucioneve të tij, duke synuar adresimin e 3 sfidave kyçe: i) Mirëqeverisjen; ii) Antikorrupsionin dhe iii) Sundimin e ligjit. Përballja me këto 3 sfida është një kontribut i ndërlidhur me angazhimet e shtetit shqiptar në kuadër të procesit të integrimit të vendit, me një angazhim më të drejtpërdrejtë të rolit të Kuvendit për përsheptimin e këtij procesi, për një reflektim më të mirë të masave të përcaktuara, përfshirje më të mirë të institucioneve të angazhuara në këtë proces dhe përmirësim të rolit të Kuvendit në monitorimin, mbikëqyrjen dhe kontrollin e realizimit të tyre, si funksione të rëndësishme kushtetuese. Në bazë të Kushtetutës dhe kuadrit ligjor në fuqi, Kuvendi ka hapësirën e duhur gjithëpërfshirëse dhe është institucioni kushtetues kyç për drejtimin, koordinimin dhe mbikëqyrjen e një procesi të tillë reformimesh, angazhimesh e veprimesh komplekse.

Në përfundim, ky plan përbën një instrument dinamik parlamentar për thellimin e reformave, i cili kërkon bashkëpunim të ngushtë ndërinstytucional, angazhim politik të vazhdueshëm dhe përfshirjen aktive të publikut dhe partnerëve ndërkombëtarë.

III. Vlerësimi i ligjshmërisë, kushtetutshmërisë dhe harmonizimi me legjislacionin në fuqi, vendas e ndërkombëtar

Projektakti është propozuar nga anëtarët e Komisionit të Posaçëm Parlamentar "Për thellimin e reformave për mirëqeverisjen, antikorrupsionin dhe sundimin e ligjit", me synimin për të

drejtuar dhe për të koordinuar një proces gjithëpërfshirës, transparent dhe profesional, në përputhje me standardet më të mira ndërkombëtare dhe në bashkëpunim me ekspertizën më të mirë kombëtare dhe ndërkombëtare, bazuar në nenin 77, pika 1, nenin 78 dhe nenin 80 pika 3 të Kushtetutës dhe neneve 24 e vijues të Rregullores së Kuvendit, si dhe në zbatim të rezolutës së Kuvendit të datës 27.5.2024.

Në vlerësimin e kushtetueshmërisë dhe ligjshmërisë, Plani Kombëtar i Veprimit është një dokument në përputhje me Kushtetutën dhe legjislacionin në fuqi në aspektin e kompetencave të Kuvendit dhe në qëllimin e hartimit të tij. Lidhur me harmonizimin me legjislacionin në fuqi, Plani Kombëtar i Veprimit është tërësisht në harmoni me të, duke përfshirë këtu jo vetëm legjislacionin, por në mënyrë specifike edhe dokumentet e politikave në këto fusha, strategjitë dhe planet e veprimit, angazhimet e shtetit shqiptar në kuadër të procesit të anëtarësimit të Shqipërisë në BE dhe në përmbushje të detyrimeve të drejtpërdrejta nga procesi i negociatave për Grup-kapitullin I “Themeloret”.

Nga përmbajtja e tij Plani Kombëtar i Veprimit nuk ka natyrë normative në kuptimin e drejtpërdrejtë, pasi nuk prodhon detyrime juridike *stricto sensu*, por përmban një numër të konsiderueshëm rekomandimesh për zbatimin e masave konkrete ligjore dhe institucionale, të cilat duhet të konvertohen në vijim në akte ligjore ose nënligjore, konform procedurave kushtetuese dhe ligjore. Për këto arsye ky plan përfaqëson një kornizë strategjike, një dokument parlamentar me karakter ndërinstitucional, i cili do të shërbejë si instrument kyç orientimi dhe bashkërendimi ndërinstitucional.

Në këtë kuptim, Plani Kombëtar i Veprimit përbën bazën analitike, konceptuale dhe orientuese të avancimit të reformave të nevojshme, të cilat Kuvendi do t’i mbështesë përmes funksioneve të tij ligjvënës dhe mbikëqyrës, duke garantuar respektimin e Kushtetutës, shtetin e së drejtës dhe angazhimeve të Shqipërisë në kuadër të procesit të negociatave me Bashkimin Europian.

IV. Vlerësimi i shkallës së përafrimit me *acquis* të BE

Plani Kombëtar i Veprimit nuk synon përafrimin me ndonjë akt të *acquis*-së të BE-së, por adreson rekomandimet e raportit të Komisionit Europian 2024 për shtetin e së drejtës, raportit të progresit të Komisionit Europian për Shqipërinë për vitin 2024, bazat e procesit të anëtarësimit dhe Kapitullit 23 “Gjyqësori dhe të drejtat themelore” dhe Kapitullit 24 dhe është në linjë me angazhimet e marra nga Shqipëria në kuadër të udhërrëfyesit për Grup-kapitullin I “Themeloret” “Për shtetin e së drejtës”, udhërrëfyesit “Për reformën në administratën publike”, udhërrëfyesit “Për funksionimin e institucioneve demokratike”, Agjendën Kombëtare të Reformave 2024-2030, pozicionit negociues për Grup-kapitullin I “Themeloret” dhe piketat hyrëse, të ndërmjetme dhe ato mbyllëse të pozicionit të përbashkët të BE-së për këtë grup-kapitull.

V. Përmbledhje shpjeguese e përmbajtjes së projektaktit

Plani Kombëtar i Veprimit është një dokument që përcakton masa konkrete, me afatet dhe institucionet përgjegjëse të përcaktuara, të cilat synojnë përmbushjen e detyrave dhe përgjegjësi të Kuvendit, në kuadër të procesit të negociatave të anëtarësimit të Shqipërisë në Bashkimin Europian, me fokus kryesor, thellimin e reformave me hapa konkretë në luftën kundër korrupsionit për qeverisjen e mirë dhe sundimin e ligjit.

Prioritet kryesor në këtë Plan Veprimi mbetet rritja e rolit të Kuvendit mbi proceset e lidhura në kuadër të negociatave që prekin tri shtyllat: “Mirëqeverisjen”, “Antikorrupsionin” dhe “Shtetin e së drejtës. Si rrjedhojë, një pjesë e mirë e masave janë planifikuar në drejtim të hartimit dhe miratimit të akteve ligjore që iniciohen nga Kuvendi dhe që janë pjesë e angazhimeve të Shqipërisë në procesin e negociatave (piketat hapëse, të ndërmjetme, si dhe piketat mbyllëse), rritjes së angazhimit dhe ngritjes së kapaciteteve të Kuvendit për të ndjekur dhe për të monitoruar procesin e negociatave me BE.

Konkretisht, ky Plan Kombëtar Veprimi për të tria shtyllat përfshin 56 fusha tematike dhe 245 masa specifike, nga të cilat 71 masa ligjore dhe 174 masa institucionale.

Të ndara sipas tri shtyllave kryesore, totali i masave ka shpërndarjen si më poshtë:

- Mirëqeverisja: 25 fusha tematike; 68 masa (16 nisma ligjore; 52 masa institucionale).
- Antikorrupsioni: 8 fusha tematike; 95 masa specifike (38 nisma ligjore; 57 masa institucionale).
- Sundimi i ligjit: 23 fusha tematike; 82 masa (17 nisma ligjore; 65 masa institucionale).

Masat e propozuara në këtë plan mbështeten në një kombinim të analizës ligjore dhe kërkimore për dokumente, raporte dhe studime të disponueshme në secilën prej shtyllave dhe prioritarizimit të gjetjeve të kësaj analize në përputhje me angazhimet e Shqipërisë në procesin e negociatave (piketat hapëse, të ndërmjetme, si dhe piketat mbyllëse), rritjes së angazhimit dhe ngritjes së kapaciteteve të Kuvendit për të ndjekur dhe për të monitoruar procesin e negociatave me BE-në.

Masat dhe ndërhyrjet që propozohen kanë karakter ligjor, institucional por edhe karakter specifik që adresojnë ndërmarrjen e reformave madhore në kuadër të Shqipërisë 2030.

Në mënyrë të sintetizuar ky projektakt në shtyllën “Mirëqeverisja” parashikon masat kryesore si më poshtë:

- Monitorimi dhe analiza e zbatimit të ligjit nr. 146/2014 “Për njoftimin dhe konsultimin publik” nga Kuvendi në bashkëpunim me organizata të shoqërisë civile dhe të botës akademike.
- Amendimi i ligjit nr. 146/2014 “Për njoftimin dhe konsultimin publik” mbi bazën e një konsultimi të gjerë publik.
- Rritja e transparencës për procesin e anëtarësimit në BE, në veçanti duke pasuruar faqet zyrtare të institucioneve publike me informacione të thjeshtuara për qytetarët/bizneset.
- Rritja e bashkëpunimit të Kuvendit, organeve të vetëqeverisjes vendore, organeve të pavarura dhe ekzekutivit për detyrimet që rrjedhin nga anëtarësimi në BE dhe hartimi i një kurrikule trajnimit të dedikuar për organet e vetëqeverisjes vendore për anëtarësimin në BE dhe zbatimin e *acquis*-së.
- Vlerësimi i nevojave për miratimin e një ligji për rregullimin e procesit të vlerësimit të ndikimit rregullator në hartimin e politikave.
- Monitorimi i procesit të publikimit të kodeve të etikës dhe planeve të integritetit të organeve që raportojnë në Kuvend, përfshirë edhe Kuvendin.
- Vlerësimi i nevojave për amendimin e ligjit nr. 138/2015, datë 17.12.2015, "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike".

- Amendimi i ligjit nr.90/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”.
- Finalizimi dhe miratimi i Strategjisë së re Ndërsektoriale të Reformës në Administratën Publike (SNRAP).
- Ndryshimi i ligjit 152/2013, “Për nëpunësin civil”.
- Hartimi i udhëzuesve për promovimin e përfshirjes dhe pjesëmarrjes aktive të qytetarëve në vendimmarrjen e politikave në nivel vendor.
- Rritja e transparencës, performancës dhe llogaridhënies së ndërmarrjeve shtetërore.
- Harmonizimi i legjislacionit të posaçëm sektorial me Kodin e Procedurave Administrative.
- Miratimi i ligjit për identifikimin elektronik dhe shërbimet e besimit, që synon të përafrohet me Rregulloren Europiane të Identitetit Digjital, që krijon kornizën e re të shërbimeve të identitetit digjital dhe të besimit të BE-së dhe përafrimi me direktivën e privatësisë elektronike.
- Rishikimi i kuadrit ligjor për transpozimin e plotë të Rregullores (EU) 2022/2065 së Parlamentit European dhe Këshillit, datë 19.10.2022, për një treg të vetëm të shërbimeve digjitale që ndryshon direktivën 2000/31/EC (Rregullorja e Shërbimeve Digjitale) dhe Rregullores (EU) 2022/1925 të Parlamentit European dhe Këshillit, datë 14.9. 2022, për mbrojtjen e tregjeve në sektorin digjital që ndryshon direktivat (EU) 2019/1937 dhe (EU) 2020/1828 (Rregullorja e Tregjeve Digjitale).
- Miratimi i Strategjisë për Inteligjencën Artificiale.
- Ngritja e këshillit fiskal.
- Krijimi i praktikës për diskutimin e kuadrit makro-fiskal dhe programit buxhetor afatmesëm në Kuvend;
- Përshtatja e legjislacionit të PPP/koncesioneve me direktivat e Bashkimit European.
- Vlerësimi i nevojave për përmirësimin e angazhimit parlamentar, si pjesë integrale e filozofisë së qeverisjes së hapur dhe si një element kryesor për realizimin e reformave.
- Vlerësimi i nevojave për përmirësimin e efektivitetit, eficiencës dhe performancës së administratës publike që u shërben qytetarëve, përmes ofrimit të shërbimeve publike cilësore.

Në shtyllën “Antikorrupsioni” parashikohen në mënyrë të përmbledhur masat, si më poshtë:

- Përmirësimi i kuadrit ligjor dhe institucional për parandalimin dhe luftën kundër korrupsionit dhe hartëzimi i qartë i arkitekturës institucionale mbi bazën e analizës përkatëse.
- Vlerësimi mbi bazën e një analize të thelluar të nevojave për fuqizimin e strukturave për parandalimin e korrupsionit, si dhe për përcaktuar qartësisht kompetencat e institucioneve përgjegjëse.
- Vlerësimi i mundësisë për ngritjen e një komisioni të përhershëm ose një nënkomisioni parlamentar në përbërje të Kuvendit, me fokus monitorimin, koordinimin, raportimin, vlerësimin dhe plotësimin e kuadrit institucional për parandalimin dhe luftën kundër korrupsionit, duke marrë si bazë modelet më të mira në vendet e BE-së.
- Përmirësimi i kuadrit rregullator për konfliktin e interesit.
- Përmirësimi i kuadrit rregullator për etikën për deputetët, anëtarët e Këshillit të Ministrave dhe këshilltarët politikë.
- Rregullimi i veprimtarisë së lobimit nëpërmjet një ligji specifik.
- Vlerësimi i nevojës për rishikimin e ligjit nr. 60/2016, datë 02.06.2016 "Për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve", i ndryshuar”.

- Fuqizimi i rolit të ILDKPKI-së në verifikimin e pasurisë së zyrtarëve; rritja e eficientës, transparencës dhe llogaridhënies.
- Ndërhyrje në kuadrin ligjor zgjedhor për përcaktimin e detyrimeve të palëve të treta.
- Miratimi i një ligji të posaçëm “Për financimin e partive politike”, si një domosdoshmëri për të përafuar legjislacionin vendas me atë të BE-së, ashtu si dhe për të parandaluar korrupsionin;
- Vlerësimi i nevojave për ndryshimin e ligjit nr. 112/2015 “Për inspektimin financiar publik”.
- Vlerësimi i nevojave për ndryshimin e kuadrit ligjor të funksionimit të KLSH-së, bazuar në analizë të thelluar në këtë fushë me ekspertizë ndërkombëtare;
- Përmirësimi i kuadrit ligjor për marrëveshjet në prokurime.
- Miratimin e konventës së OECD-së “Për luftën kundër ryshfetit të zyrtarëve publikë të huaj në transaksionet e biznesit ndërkombëtar”.
- Vlerësim i risqeve të korrupsionit në sektorët me risk të lartë, si tatime, dogana, pronat, arsim, shëndetësia, prokurimet publike dhe koncesionet/PPP etj.
- Forcimi i integritetit në Policinë e Shtetit.
- Zbatimi efektiv i procesit të vetingut, forcimi i mekanizmave të kontrollit të integritetit dhe mbikëqyrja e përdorimit të mjeteve të komunikimit të enkriptuar nga punonjësit e Policisë së Shtetit.
- Rritja e efikasitetit të kontrolleve dhe përmirësimi i procedurave për përzgjedhjen e subjekteve për inspekte, duke garantuar që përzgjedhja e subjekteve të jetë automatike dhe e bazuar në kritere të qarta dhe të mirëpërcaktuara;
- Harmonizimi i kuadrit ligjor me zhvillimet e reja të legjislacionit doganor të BE.
- Avancimi i digjitalizimit të shërbimeve doganore dhe përmirësimi i vazhdueshëm i sistemeve të informacionit për t’i përafuar me mjedisin elektronik doganor të BE-së.
- Vlerësimi i nevojës për përmirësim dhe harmonizim të mëtejshëm të ligjit për prokurimin publik me acquis-së së BE-së.
- Përmirësimi i sistemit të prokurimit elektronik (SPE).
- Analizimi i nevojave për përmirësimin e ligjit për investimet strategjike.
- Ndryshime në Kodin Penal për të rregulluar përkufizimin e krimit të organizuar.

Në shtyllën “Sundimi i ligjit” parashikohen në mënyrë të përmbledhur masat, si më poshtë:
Ndryshimi i Rregullores së Kuvendit për:

1. Fuqizimin e procedurës për konsultimin publik.
2. Forcimin e mbikëqyrjes parlamentare ndaj qeverisë dhe monitorimit të institucioneve të pavarura dhe përmirësimin e një mekanizmi efektiv për përgjigjen e ekzekutivit ndaj rekomandimeve parlamentare dhe atyre të institucioneve të pavarura.
3. Përfshirjen e përfaqësuesve të IKDNJ-së në procesin konsultues ligjvënës kur konsultohen projektakte, që kanë lidhje me fushën e veprimit të tyre.
4. Monitorimi i zbatimit të vendimeve të Gjykatës Kushtetuese, përcaktimi i dispozitave për kryesimin e mbledhjeve në rast mungese të kryesuesit dhe respektimin e afateve të përcaktuara nga Gjykata Kushtetuese në vendimet e saj.
5. Parashikimi në Rregullore i përdorimit efektiv të legjislacionit elektronik nëse është i nevojshëm.
6. Rishikimi i organizimit dhe i fushës së veprimtarisë së komisioneve të përhershme parlamentare.
7. Mirëpërcaktimi i modaliteteve për ushtrimin e të drejtës për peticionin dhe e-Peticion.

- Monitorimi i procesit të kalimit në një sistem plotësisht të integruar e-Legjislacioni, duke siguruar ndërveprim efikas me institucionet e tjera të përfshira në procesin legjislativ.
- Monitorimi i krijimit të platformës për konsultimin e projektligjeve, duke përfshirë edhe hartimin e udhëzimeve elektronike miqësore për përdoruesit dhe organizimi i fushatave ndërgjegjësuese për njohjen dhe përdorimin e kësaj platforme.
- Realizimi i një studimi për ndryshimin e ligjit nr.8480, datë 27.5.1999, "Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike".
- Ndryshime në ligjet organike të institucioneve të pavarura, që janë subjekte raportimi dhe monitorimi nga Kuvendi për standardizimin e raportimit të tyre.
- Krijimi i mekanizmit të monitorimit të jashtëm me grup ekspertësh që vijnë nga OSHC-të, universitetet dhe profesionet e lira për një monitorim gjithëvjeter të veprimtarisë së institucioneve të pavarura dhe vlerësimi i mundësisë për përmirësimin e metodologjisë së raportimit dhe monitorimit.
- Përgatitja e një studimi në lidhje me ndryshimet e pritshme të kuadrit ligjor për të përfshirë koncepte, si: marrëdhëniet mes Kuvendit të Shqipërisë dhe Parlamentit European, parimin e subsidiaritetit në përputhje me Rregulloren e punës së Parlamentit European 1 vit para aderimit.
- Monitorimi i zbatimit të një sistemi transkriptimi me inteligjencë artificiale për mbledhjet e komisioneve parlamentare dhe seancat plenare brenda vitit 2028.
- Realizimi i një analize dhe vlerësimi i kuadrit ligjor për përmirësimin e cilësisë, transparencës, gjithëpërfshirjes në procesin e zgjedhjes së kryetarëve dhe anëtarëve të institucioneve të pavarur.
- Rishikimi i ligjit "Për Avokatin e Popullit", me qëllim plotësimin e rekomandimeve të BE-së për publikimin e raportit vjetor (neni 28) dhe ndryshime të tjera në përputhje me nevojat institucionale dhe në përputhje me Parimet e Parisit.
- Monitorimi i përfundimit të digjitalizimit të të gjitha kartelave fizike dhe hartave kadastrale të mbetura deri në fund të vitit 2027, duke siguruar ruajtjen në sisteme digjitale të siguruara.
- Monitorimi i regjistrimit të pronave në pronësi të bashkive dhe identifikimi i pronave publike për të krijuar një bazë të dhënash të plotë dhe të integruar.
- Monitorimi i rishikimit dhe miratimi i dokumentit të politikës së tokës dhe metodologjisë për monitorimin e politikës, duke përfshirë një mekanizëm ndërinstytucional monitorimi.
- Mbikëqyrja nga Kuvendi e realizimit të vlerësimit financiar dhe alokimit të fondeve për zbatimin e vendimeve të GJEDNJ-së.
- Monitorimi i zhvillimit të programeve të trajnimit vjetor për gjyqtarët dhe prokurorët për standardet e GJEDNJ-së për të drejtat e pronës.
- Monitorimi i procesit të zgjerimit rajonal të shtrirjes së zyrave të AP-së dhe KMD-së.
- Rishikimi i ligjit "Për mbrojtjen nga diskriminimi", me qëllim përafrimin e plotë me direktivën e Këshillit 2000/43/KE, 29.6.2000, direktivën 2024/1499 dhe 2024/1500, direktivën 2019/882.
- Monitorimi dhe rishikimi i ligjit "Për dhunën ndaj grave" në përputhje të plotë me direktivat e BE-së dhe rekomandimet e komiteve ndërkombëtare të mbrojtjes së të drejtave të grave dhe dhunës ndaj grave e vajzave;
- Monitorimi nga Kuvendi dhe rishikimi i ligjit "Për kujdesin alternativ" në përputhje me direktivat e BE-së.

VI. Institucionet dhe organet që ngarkohen për zbatimin e aktit

Në qendër të zbatimit të masave të parashikuara në Planin Kombëtar të Veprimit, është vetë Kuvendi dhe strukturat e tij në përputhje me ushtrimin e funksioneve të tij ligjvënese e mbikëqyrëse.

Ngarkohen gjithashtu për zbatimin e këtij projektakti, sipas fushave të përfshira në Planin Kombëtar të Veprimit 2025-2030 (të përcaktuara qartë), ministritë e linjës dhe institucionet në varësi të tyre, si dhe institucionet e pavarura përgjegjëse për realizimin e masave të parashikuara.

Ndër ministritë dhe institucionet në varësi të tyre përfshihen: Ministria e Drejtësisë, Ministria e Financave, Ministria e Brendshme, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Ministria e Arsimit dhe Sportit, Ministri i Shtetit për Administratën Publike dhe Antikorrupsionin, Ministri i Shtetit për Marrëdhënien me Parlamentin, Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit, Agjencia e Trajtimit të Pronave, Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Departamenti i Administratës Publike, Shkolla Shqiptare e Administratës Publike, Avokatura e Shtetit; Agjencia e Prokurimit Publik, Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, Agjencia për Mbështetjen e Shoqërisë Civile, Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve etj.

Për të garantuar realizimin e suksesshëm të masave të parashikuara në PKV është ndërtuar një strukturë e qartë dhe funksionale monitorimi, e cila kombinon mbikëqyrjen institucionale, transparencën publike dhe përfshirjen e të gjitha palëve të interesit. Në qendër të kësaj strukture qëndron komisioni parlamentar përkatës, i cili ushtron funksionin udhëheqës dhe mbikëqyrës të zbatimit të planit. Vlerësimi i përparimit do të kryhet në mënyrë të vazhdueshme, përmes raportimeve periodike çdo tre muaj dhe analizave përmbledhëse vjetore, të cilat do të pasqyrojnë nivelin e realizimit të objektivave, në bazë të indikatorëve të qartë dhe të matshëm. Në këtë proces do të luajnë rol të rëndësishëm edhe përfaqësuesit e shoqërisë civile dhe partnerët ndërkombëtarë, të cilët do të kontribuojnë për monitorimin e jashtëm, duke ofruar një perspektivë të pavarur dhe gjithëpërfshirëse. Gjithashtu, parashikohet funksionimi i një platforme digjitale të dedikuar, që do të shërbejë si kanal komunikimi dhe transparence për publikun, duke mundësuar akses të hapur në informacion për ecurinë e zbatimit dhe rezultatet e arritura.

Bashkëpunimi me organizatat e shoqërisë civile dhe grupet e interesit, kanë rëndësi themelore, pasi ato ndikojnë ndjeshëm për zhvillimin e standardeve rreth procesit të reformave madhore të drejtësisë. Ato duhet të luajnë një rol të rëndësishëm edhe në monitorimin e zbatimit të këtij Plani Veprimi.

VII. Ministritë, institucionet dhe subjektet e tjera që kanë kontribuar për hartimin e projektaktit

Projektakti është hartuar nga Grupi i Ekspertëve të Nivelit të Lartë (GENL) me mbështetjen e Sekretariatit Teknik (ST) të Kuvendit dhe në konsultim të gjerë me publikun, institucionet dhe organizatat ndërkombëtare.

Bazuar në vendimmarrjen e KPP-së, gjatë periudhës shkurt 2025, GENL & ST zhvilluan një proces të gjerë konsultimi për draftin e PKV-së, fillimisht në nivel teknik me institucionet shtetërore përgjegjëse për fushat respektive, në vijim në tryeza diskutimi me përfaqësues të

institucioneve të pavarura, të agjencive të ndryshme ekzekutive, grupeve të interesit, komunitetit të biznesit dhe shoqërisë civile.

Gjatë muajit mars 2025 paralelisht u reflektuan vlerësimet, komentet dhe sugjerimet e dërguara nga konsulentët e huaj dhe ata të diasporës, të angazhuar në këtë proces dhe nga ekspertët e institucioneve ndërkombëtare të atashuar pranë këtij komisioni për monitorimin dhe asistencën ndaj tij.

Draft Plani Kombëtar i Veprimit u prezantua si dokument publik në Konferencën e II^ë të Nivelit të Lartë, datë 3.4.2025, në Pallatin e Kongreseve, ku morën pjesë përfaqësues të trupit diplomatik dhe organizatave ndërkombëtare, ministra, deputetë, përfaqësues nga institucionet shtetërore, agjencitë ligjzbatuese, shoqëria civile, ekspertë të atashuar pranë Komisionit të Posaçëm “Për mirëqeverisjen, antikorrupsionin dhe sundimin e ligjit”. Krahas panelit kryesor të hapjes, u zhvilluan 3 panele diskutimi, sipas 3 shtyllave, ku ekspertët e GENL-së prezantuan draftet përkatëse të PKV-së. Në këto tryeza debati u shfaqën vlerësime dhe komente nga përfaqësues të shoqërisë civile, komunitetit të biznesit, institucioneve publike dhe nga një sërë ekspertësh ndërkombëtarë që ishin pjesë aktive e këtyre tryezave, si më poshtë:

Ndër institucionet që janë përfshirë në konsultime përmendim: Kryeministrinë, Ministrin e Shtetit dhe Kryenegociator, Ministrin e Shtetit për Administratën Publike dhe Antikorrupsionin, Ministrinë për Europën dhe Punët e Jashtme, Ministrin e Shtetit për Marrëdhëniet me Parlamentin, Ministrinë e Drejtësisë, Ministrinë e Financave, Ministrinë e Brendshme, Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Ministrinë e Arsimit dhe Sportit, Ministrin e Shtetit për Pushtetin Vendor, Agjencinë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit, Agjencinë e Trajtimit të Pronave, Agjencinë Shtetërore të Kadastrës, Avokaturën e Shtetit, Departamentin e Administratës Publike, Inspektoratin Qendror, Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit, Shërbimin e Përmbarimit Shtetëror, Agjencinë e Prokurimit Publik, Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave, Agjencinë për Mbështetjen e Shoqërisë Civile, Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve, Këshillin e Investimeve, Agjencinë e Inteligjencës Financiare, Këshillin e Lartë të Prokurorisë, Prokurorinë e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, Avokatin e Popullit, Komisionerin për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, Komisionin e Prokurimit Publik, Komisionerin për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, Kontrollin e Lartë të Shtetit, Inspektoratin e Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave, Bankën e Shqipërisë, Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare, Autoritetin e Konkurrencës, Këshillin Drejtues të RTSH-së, Agjencinë e Sigurimit të Depozitave, Komisionerin për Mbrojtjen nga Diskriminimi, Autoritetin e Komunikimeve Elektronike dhe Postare, Autoritetin e Medieve Audiovizive, Institutin e Statistikave, Enti Rregullator të Energjisë, Entin Rregullator të Ujit, Komisionin Qendror të Zgjedhjeve etj.

Nga grupet e interesit janë konsultuar: shoqata të biznesit, Bashkimi i Dhomave të Tregtisë dhe Industrisë së Shqipërisë, Biznes Albania, Dhoma Amerikane e Tregtisë, Dhoma Gjermane e Tregtisë, Dhoma Ndërkombëtare e Tregtisë në Shqipëri, NAREA, Shoqata e Bankave, OSHC të ndryshme, bota akademike, sindikatat, Dhoma Kombëtare e Noterëve, Dhoma Kombëtare e Avokatëve, Shkolla e Magjistraturës etj.

Ky dokument është konsultuar me përfaqësues të organizatave ndërkombëtare, si delegacioni i Bashkimit Europian, Komisioni Europian, OSBE-ja, Këshilli i Europës, WFD, UNDP-ja,

NDI-ja, USAID-i, OGP-ja, OECD-ja, KAS-i, GIZ Albania, FES-i, si dhe përfaqësues të trupit diplomatik në Shqipëri, si ambasadat holandeze, gjermane, zviceriane, greke, franceze, etj.

Gjatë periudhës prill-qershor 2025, drafti i PKV-së ka qenë i publikuar në faqen ueb “www.masl.al” të KPP-së, si pjesë e procesit të konsultimit publik dhe në përmbushje të parimeve të gjithëpërfshirjes, transparencës dhe profesionalizmit, të cilat kanë përshkruar gjithë procesin e kësaj reforme të ndërmarrë nga Kuvendi, përmes këtij komisioni të posaçëm.

KPP-ja i kërkoi Kryenegociatorës vlerësimet zyrtare rreth PKV-së nga ana e grupit të të gjithë negociatorëve të shtetit shqiptar, të angazhuar në procesin e negociatave, për të vlerësuar përputhshmërinë e këtij dokumenti me angazhimet konkrete të shtetit shqiptar, në kuadër të negociatave dhe rekomandimeve të dhëna në këtë proces nga BE-ja. Kështu, më konkretisht, ky dokument është verifikuar paralelisht me Agjendën Kombëtare të Reformave 2024-2030; me 3 udhërrëfyesit në fuqi “Për shtetin e së drejtës”, “Për reformën në administratën publike” dhe “Për funksionimin e institucioneve demokratike”; me piketat e ndërmjetme dhe përmblylëse, për të cilat raportohet në Komisionin Europian në kuadër të Grup-kapitullit I “Themeloret”, si dhe me strategjitë ndërsektoriale relevante për drejtësinë, kundër korrupsionit, për reformën në administratën publike, agjendën digjitale, për decentralizmin dhe vetëqeverisjen vendore, për menaxhimin e financave publike etj.

Në mënyrë të përmbledhur, dokumenti i përcjellë prej tyre gjatë muajit qershor përmban: i) propozime për të përforcuar rolin e Kuvendit në ndjekjen dhe miratimin e legjislacionit për përmbushjen e piketave të ndërmjetme në kapitujt 23 dhe 24; ii) sugjerime për reduktimin e nismave ligjore afatshkurtra, që nuk lidhen drejtpërdrejt me negociatat e anëtarësimit; iii) ndryshime në afatet kohore të realizimit të masave, për të qenë në përputhje me detyrimet ndaj BE-së, me qëllim për t’i afruar ato në kohë; iv) ndryshim apo shtim të institucioneve përgjegjëse për masa të caktuara; v) riformulime të disa masave të parashikuara.

Ndër propozimet e bëra nga grupi i negociatorëve ka pasur edhe disa risi si më poshtë:

- Përcaktimin e një “*modus operandi*” midis pushtetit legjislativ dhe atij ekzekutiv për përshpejtimin e përmbushjes së kërkesave për integrimin e Shqipërisë në Bashkimin Europian.
- Ngritjen e mekanizimit të "Trilogut" në procesin e nismave ligjore. Me qëllim përshpejtimin dhe përmirësimin e cilësisë së procesit të përafrimit të legjislacionit kombëtar me *acquis*-në e BE-së, rekomandohet ngritja e një mekanizmi formal “Trilogu” në nivel kombëtar nga Kuvendi, i përbërë nga përfaqësues të Kuvendit, qeverisë dhe pushtetit gjyqësor për çështje që kërkojnë konsensus midis tri pushteteve (një praktikë që përdoret nga Bashkimi Europian).

Gjatë gjithë këtij procesi konsultimi të realizuar në funksion të draftit të PKV-së, ekspertët e GENL-së për të tria shtyllat kanë mbledhur dhe kanë analizuar rreth 160 komente të ardhura nga aktorë të ndryshëm, duke përfshirë edhe grupin e negociatorëve. Komentet dhe sugjerimet e tyre u vlerësuan me shumë përgjegjësi nga ekspertët e GENL&ST, duke garantuar edhe në këtë aspekt harmonizimin e plotë të këtij dokumenti, në funksion të përmbushjes së

angazhimeve që ka shteti shqiptar, me fokus rritjen e rolit të Kuvendit të Shqipërisë, në kuadër të përgatitjeve për anëtarësimin në Bashkimin Europian dhe zbatimin e paketës së re ligjore, si angazhim e detyrim i këtij procesi, si dhe për fuqizimin e kontributit dhe rolit aktiv të Kuvendit në forcimin e mirëqeverisjes, antikorrupsionit dhe sundimit të ligjit në përputhje me përcaktimet e bëra në rezolutën e Kuvendit.

Është e rëndësishme të theksohet se Komisioni Europian ka nënvizuar faktin se viti 2025 duhet të konsiderohet edhe si viti i “Themeloreve”, ku Shqipëria duhet të plotësojë piketat e ndërmjetme (*interim benchmarks*) në Kapitullin 23 “Gjyqësori dhe të drejtat themelore” dhe Kapitullin 24 “Drejtësia, liria dhe siguria” dhe kjo, sikurse është përmendur më sipër, është reflektuar në masat e parashikuara në Planin Kombëtar të Veprimit, për sa u përket angazhimeve në këto tri shtylla. Pra, ky plan veprimi është i përputhur plotësisht me këto dokumente të rëndësishme të dakordësuara midis shtetit shqiptar dhe Komisionit Europian.

KPP-ja, në mbledhjen e datës 3 korrik 2025, pas prezantimit të ekspertëve të nivelit të lartë dhe Sekretariatit Teknik lidhur me procesin e konsultimit dhe diskutimeve me Kryenegociatoren, grupin negociator dhe përfaqësues të tjerë të institucioneve, si dhe reflektimin e komenteve, miratoi Planin Kombëtar të Veprimit në parim dhe në të tërësi. Anëtarët e KPP-së komentuan për rëndësinë e këtij procesi dhe planit të veprimit, dhe domosdoshmërinë e përputhshmërisë të masave të PKV-së me angazhimet që qeveria ka ndërmarrë në kuadër të procesit të negociatave me BE-në. U kërkua nga anëtarët e KPP-së reflektimi qartësisht i komenteve të diskutuara dhe të reflektuara në relacionin shoqëruar të PKV-së.

VIII. Raporti i vlerësimit të të ardhurave dhe shpenzimeve buxhetore

Projektakti në vetvete nuk parashikon efekte financiare në buxhetin e shtetit, megjithatë për zbatimin e Planit Kombëtar të Veprimit pritet të nxirren kostot; burimet e nevojshme dhe institucionet e parashikuara për zbatimin e tij.

PROPOZUES

Deputetët e Komisionit të Posaçëm Parlamentar “Për thellimin e reformave për mirëqeverisjen, sundimin e ligjit dhe antikorrupsionin për Shqipërinë 2030 në Bashkimin Europian”:

DOKUMENT PARLAMENTAR